



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASËN MIRJANË TURHANI
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Spektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Mirjanë Turhani** më datë **27.08.2024**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 15.12.2023”, për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj:

JU RELATOJ:

Familja e **Znj. Mirjanë Turhani** me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, e përbërë prej dy anëtarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.

Znj.Mirjanë Turhani trajtohet me pagesë paaftësie niveli i lehtë me vlerën 7729 lekë në muaj.Në vitin 2021 është diagnostifikuar me një sëmundje të rëndë, është trajtuar me kimio terapi dhe rreze. Gjithashtu është mjekuar edhe jashtë shtetit Shqiptar por shpenzimet janë të pa përballueshme për ti paguar. Për shkak të vështirësisë financiare ka të ndërprerë mjekimin.

E ndodhur në këto kushte të vështira për shëndetin e Znj.Mirjanë Turhani, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasen Mirjanë Turhani.

**Përgjegjëse e NE dhe PAK-së
Teuta Hysenbelliu**

